


# MANUAL PËR PJESËMARRJEN NË MBLEDHJEN PLENARE ONLINE TË KLGJ NËPËRMJET PROGRAMIT KOMPJUTERIK “MICROSOFT TEAMS”


## Pranimi i ftesës nga posta elektronike dhe hyrja në portal.

Personave të interesuar u dërgohet ftesa nëpërmjet postës elektronike për të marrë pjesë në mbledhjen plenare të KLGJ nëpërmjet programit kompjuterik “Microsoft Teams”.


1. Klikoni mbi “Join Microsoft Teams Meeting”, (shih figurën ilustruese).




2. Pasi të drejtoheni në faqen zyrtare të Microsoft-it, klikoni mbi ikonën “Join on the web instead”, meqenëse kjo mundëson hyrjen pa pasur një llogari aktive në programin kompjuterik “Microsoft Teams” (shih figurën ilustruese).



3. Pasi të shfaqet ikona e radhës, fillimisht duhet të lejoni përdorimin e mikrofonit dhe kamerës tuaj nga shfletuesi elektronik (browser) që po përdorni (shih figurën ilustruese).



4. Vendosi “Emrin Mbiemrin” tuaj dhe sigurohuni që kamera dhe mikrofoni juaj janë të mbyllur, përpara hyrjes në mbledhjen plenare.
5. Klikoni “**Join now**” (shih figurën ilustruese).



Ju tashmë keni hyrë në Mbledhjen Plenare online të KLGJ, nëpërmjet programit kompjuterik “Microsoft Teams”.

**Ju lutemi të ftuarve që të ndjekin procedurën e mësipërme 10-15 minuta përpara fillimit të mbledhjes, në mënyrë që personeli përgjegjës për mbarëvajtjen e mbledhjes të ketë mundësinë t’ju lejojë të merrni pjesë në Mbledhjen Plenare nëpërmjet programit kompjuterik “Microsoft Teams”.**

**Kjo procedurë ndiqet edhe nga anëtarët e KLGJ, e nëse të gjithë të interesuarit do të kërkonin të futeshin pak para fillimit të mbledhjes, apo pas fillimit të saj, personeli përgjegjës ka prioritet futjen e anëtarëve të KLGJ, e nuk do të ketë mundësinë objektive të merret me kërkesat e të ftuarve.**

**Prandaj, në interes të zhvillimit sa më normal të Mbledhjes Plenare dhe për të shmangur çdo ndërhyrje apo interferencë sinjali që pengon mbarëvajtjen e saj, nuk do të mundësohet pranimi në Mbledhjen Plenare pasi ajo të ketë filluar.**

**Ju lutemi të ftuarve që të mos përdorin programe të tjera për transmetim drejtpërdrejt ose për regjistrim, si dhe të mos shfaqin asnjë imazh tjetër në ekran. Në zbatim të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, administrata e KLGJ merr të gjitha masat e nevojshme që çdo mbledhje plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor të dokumentohet në mënyrë të përshtatshme përmes regjistrimit audio dhe procesverbalit me përmbledhjen e diskutimeve, të cilat bëhen publike.**

**JU FALEMINDERIT!**